# INFORMATA MBI GRANTIN

| | |
|---|---|
| Emri i grantit: | Forcimi i pjesëmarrjes së OSHC-ve nga radhët e komunitetit serb të Kosovës në proceset e vendimmarrjes në nivelin qendror në Kosovë |
| Instrumenti: | Grant i mesëm për projekt |
| Subjekti zbatues: | NGO AKTIV |
| Kontaktet (adresa, emaili, telefoni, website): | Kralja Petra I, 183/a, Mitrovica e Veriut<br>info@ngoaktiv.org<br>+383 44 645 938<br>http://ngoaktiv.org/ |
| Kohëzgjatja e grantit: | Data e fillimit: 01/09/2022<br>Data e përfundimit: 31/10/2023 |
| Buxheti total i grantit (EUR): | 38,975.00 EUR |
| Buxheti i mbështetur nga programi EJA Kosovë (EUR): | 38,975.00 EUR |
| Grupet e synuara: | 1) Pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës<br>2) Organizatat e shoqërisë civile që përfaqësojnë interesat e komunitetit serb të Kosovës<br>3) Vendimmarrësit dhe politikëbërësit në nivel qendror e lokal (në pushtet ) |
| Shtrirja gjeografike: | Kosovë |
| Përmbledhje e grantit: | Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti është rritja e pjesëmarrjes së përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile (OSHC) të serbëve të Kosovës në proceset e formulimit të politikave në institucionet e nivelit qendror në Kosovë, ashtu që të përmbushen interesat e ndryshme të komuniteteve jo-shumicë, posaçërisht komunitetit serb të Kosovës, gjë që do të reflektohej pastaj në vendimmarrjet në nivelin qendror, politikat qeveritare dhe strategjitë nacionale. Në këtë drejtim, platforma avokuese Empirika, që e udhëheq OJQ AKTIV, do të udhëheqë tri seri aktivitetesh (të ashtuquajtura SoAs; duke përjashtuar aktivitetet për planifikim dhe  përgatitje), që për pasojë do të kenë tri rezultate kryesore:<br><br>**SoAs 1:** Nisma që rrisin pjesëmarrjen dhe kapacitetet e të OSHC-ve të serbëve të Kosovës në procese të nivelit qendror, mekanizmave qeveritarë për  konsultime, si dhe platforma të politikave nacionale; → Rezultati 1) Rritje e pjesëmarrjes, bashkëpunimit e komunikimit të OSHC-ve të serbëve të Kosovës me institucionet në nivel qendror |

Bashkëfinancuar nga:

| | |
|---|---|
| | (vendimmarrësit), si dhe kapacitete më të mira për përcjellje të detajuar të ngjarjeve aktuale kulturore, shoqërore, politike e ekonomike.<br><br>2) **SoAs 2**: Nisma që mbështesin profesionalizimin e politikave të organizatave anëtare të Empirika-s, si dhe shkathtësive për implementimin e tyre, të cilat si pasojë do të ndihmonin në hartimin e propozim-politikave; → **Rezultati 2)** Informim më i mirë i Qeverisë së Kosovës për problemet dhe zgjidhjet lidhur me të drejtat e komuniteteve jo-shumicë në Kosovë, sidomos atyre që lidhen me komunitetin serb të Kosovës.<br><br>3) **SoAs 3**: Nisma për rritjen e aftësive të OSHC-ve të serbëve të Kosovës që të angazhohen në implementim të politikave dhe komunikim të politikave të propozuara me institucionet në nivelin qendror si dhe me vendimmarrësit; → **Rezultati 3)** Implementimi i politikave praktike nga ana e institucioneve në nivelin qendror, për të avansuar të drejtat e komuniteteve jo-shumicë në Kosovë, sidomos atyre që kanë të bëjnë me komunitetin serb të Kosovës. |